REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4354/2 Prot

Rrëshen, më 01 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 84 datë 25. 09. 2026
PËR
"MIRATIMIN, PËRDORIM FOND MBROJTJES CIVILE", BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore",ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile",ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKM nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit, për mbrojtjen civile" *i ndryshuar*, Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", Vendimin nr. 98, datë 10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", *Relacion nr. 4354 prot, datë 24.09.2026, "Për përdorim fond emergjencave civile"*, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit,* për t'ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorim fond mbrojtje civile **4 992 682** (*katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy*) lekë, si më poshtë;

   a) Fond mbrojtjes civile: **Gr.17 Tit.10910 Kap.1 Art.604 Kod prod 91707 AG**, për shumën; **4 992 682 lekë**, të përdoret për blerje materiale për ndërhyrjet në raste emergjente për objekte të ndryshme

2. Relacioni nr. 4354 prot, datë 24.09.2026, së bashku me preventivin, *bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi*

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave & APPM-Mirditë)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

S E K R E T A R
Gaspër TOPOLLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

K R Y E T A R
Aleksandër PICAKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr 4354 prot

Rrëshen me 24 /09 /2026

P/V E N D I M

Nr. 97 date 24. 9 .2026

"PËR PËRDORIM FOND MBROJTJE CIVILE"

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026",vkm nr.414, dt.08.07.2021 "Per miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ne relacionin e AIKE , ne relacionin dhe preventivin DPZHT,nr , date. , Këshilli i Bashkisë Mirditë, pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkise;

V E N D O S I:

1.Të miratojë përdorimin, e fondit të mbrojtjes civile, si më poshtë.:

a-Fondi mbrojtje civile: ***Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 604 kod prod 91707AB (AG) për shumën 4 992 682 lekë,*** të përdoret për blerje materjale , për ndërhyrjet , në rastet emergjente për objkete të ndryshme (sipas preventivit bashkëlidhur)

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

3.*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

BASHKIA MIRDITË - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI
Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr. AIKE:	F.Vorfi
Dr.PZHT	J.Tusha
Dr./finance/buxhet::	V.Gjoka
Pergj sekt juridik/	L..Gjergji

KRYETARI
Albert MËLYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
DREJTORIA E PLANIFKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 4354 **Prot.** **Rrëshen, më** 24.09 **.2026**

RELACION

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE, BASHKIA MIRDITË .

RELACION TEKNIK-SHPJEGUES

Për Këshillin e Bashkisë Mirditë,

Me lëndë kërkesë për përdorim të fondeve të emergjences për ndërhyrje urgjente në tre objekte, respektivisht këmbë ure në Zall I Zmesë Jezull, këmbë ure në fshatin Rrajë e Zezë Velë dhe këmbë ure për lidhjen e qytetit Rrëshen me unazën e qytetit.

Ky relacion paraqet situatën kritike dhe emergjente në të cilën ndodhen tre akse kalimi dhe lidhjeje në territorin e Bashkisë Mirditë ku për shkak të dëmtimeve të rënda të pësuara nga reshjet dhe prurjet e lumenjve kërkohet alokimi i menjëhershëm i fondeve financiare për blerjen e materialeve të nevojshme si beton hekur dhe inerte për rehabilitimin dhe rindërtimin e këmbëve të urave në fjalë.

Dëmtimet e raportuara kanë paralizuar infrastrukturën bazë rrugore duke shkaktuar ndërprerje totale të aksesit të banorëve me qendrat administrative, shkollat, qendrat shëndetësore dhe tregjet. Ndërhyrja kërkohet urgjentisht në tre pika kritike duke filluar nga këmba e urës në Zall Zmesë Jezull ku prurjet e mëdha ujore kanë gërryer bazamentin dhe kanë dëmtuar rëndë këmbën mbështetëse të urës duke rrezikuar shembjen totale të strukturës dhe izoluar dhjetëra familje, tek këmba e urës në fshatin Rrajë e Zezë Velë ku dëmtimi i konsiderueshëm i trupit dhe themeleve ka lënë zonën e izoluar duke pamundësuar lëvizjen e banorëve dhe transportimin e emergjencave mjekësore apo produkteve bujqësore, si dhe tek këmba e urës për lidhjen e qytetit me unazën e cila është kthyer në një nevojë emergjente për qarkullimin ku vlen të theksohet se vetë strukturën e urës Bashkia Mirditë e disponon dhe ka nevojë vetëm për ndërtimin e këmbës përkatëse.

Buxheti i Bashkisë Mirditë nuk përballon dot koston e jashtëzakonshme për sigurimin e materialeve të ndërtimit të nevojshme për riparimin e këtyre tre objekteve dhe mungesa e ndërhyrjes në kohë rekord sjell pasoja të rënda që lidhen me izolimin total të komuniteteve rurale, bllokimin e jetës ekonomike e sociale, rrezikimin e jetës së banorëve si dhe përshkallëzimin e dëmeve me çdo reshje të re.

Adresa: Sheshi "Abat Doçi" Rrëshen, tel dhe fax: (00355)(0)2162233,www.bashkiamirdite.gov.al email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

Duke u nisur sa më sipër, Bashkia Mirditë kërkon miratimin e fondit të emergjencës për blerjen e materialeve të ndërtimit me qëllim fillimin e menjëhershëm të punimeve nga strukturat tona teknike për rivendosjen e qarkullimit dhe garantimin e sigurisë publike në tre zonat e prekura.

Konc. Juljan Tusha (Drejtor DPZHT)

Konf. Frederik Vorfi (Drejtor Agjensia e Emergjencave,MZSH, Inspektimi Vendor dhe Policia Bashkiake)

KRYETARI
Albert MELYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË MIRDITË
ALBERT MËLYSHI

PREVENTIVI

OBJEKTI: BLERJE MATERIALESH PËR NDËRTIM SHPATULLA URE BASHKIA MIRDITË

POROSITËS: BASHKIA MIRDITË

	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI (lekë)	VLERA (lekë)
I	**Punime për shpatullat e urës në lumin Zalli I Zmesë (Jezull)**				
1	F hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm2, per shpatullat dhe muret rakordues	kg	6,000.00	99.00	594,000
2	F Hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm2	kg	260.00	107.00	27,820
3	Betoni C-20/25 (Me cakell)	m³	205.00	7,510.00	1,539,550
4	Çakell mbeturine per mbushje	m³	152.00	343.00	52,136
6	Transport auto deri 5 km	t/km	250.00	30.00	7,500
7	Rrjete gabion zinkat	m³	88.00	350.00	30,800
8	Rrjete gabion hekzagonal 6x8-8x10 galfan 250 g/m2 me diameter teli 2.2-2.4mm	m³	44.00	350.00	15,400
				SHUMA I	**2,267,206**
	Punime për këmbëve të urës në lumin në fshatin Rreja e Velës Rubik				
1	F hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm2, per shpatullat dhe muret rakordues	kg	5,000.00	99.00	495,000
2	F Hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm2	kg	260.00	107.00	27,820
3	Betoni C-20/25 (Me cakell)	m³	117.00	7,510.00	878,670
4	Çakell mbeturine per mbushje	m³	152.00	343.00	52,136
6	Transport auto deri 5 km	t/km	100.00	30.00	3,000
7	Rrjete gabion zinkat	m³	60.00	350.00	21,000
8	Rrjete gabion hekzagonal 6x8-8x10 galfan 250 g/m2 me diameter teli 2.2-2.4mm	m³	40.00	350.00	14,000
				SHUMA II	1,491,626
	Punime për këmbëve të urës në lumin lumin Zmeja Madhe				
1	F hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm2, per shpatullat dhe muret rakordues	kg	4,000.00	99.00	396,000
2	F Hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm2	kg	150.00	107.00	16,050
3	Betoni C-20/25 (Me cakell)	m³	100.00	7,510.00	751,000
4	Çakell mbeturine per mbushje	m³	100.00	343.00	34,300
6	Transport auto deri 5 km	t/km	50.00	30.00	1,500
7	Rrjete gabion zinkat	m³	60.00	350.00	21,000
8	Rrjete gabion hekzagonal 6x8-8x10 galfan 250 g/m2 me diameter teli 2.2-2.4mm	m³	40.00	350.00	14,000
				SHUMA III	1,233,850
				SHUMA TOTALE	**4,992,682**

Ky preventiv bazohet në manualin e ri të çmimeve të marrë nga e-albania (çmimet sipas bashkëlidhur nga e-albania, VKM Nr. 216, datë 13.04.2023)
Hartuar me 21.09.2026

PROJEKTUESIT

Ing. Daisler PEPA